

Dr. Hisham Maizar*

INTEGRIMI I MUSLIMANËVE NË ZVICËR**

Shumë i nderuari kryetar i shkollave të Kreuzlingenit, z. Jürg Schenkel,
Shumë i dashuri dr. Ismail Bardhi,
Shumë i dashuri dr. Hamit Duran,
Shumë i dashuri imam, mr. Rejhan Neziri,
Shumë i dashuri mr. Bekim Alimi,
Shumë të nderuar zonja dhe zotërinj!

Krejt në fillim kam një gëzim të jashtëzakonshëm që sonte në emrin tim personal, në emër të të gjithë anëtarëve të Lidhjes së Bashkësive Islame të Zvicrës Lindore dhe të Principatës së Lichtensteinit, shkurt e quajtur DIGO, t'Ju përcjell përshëndetjet më të përzemërta.

Më tej **ndjej nevojën**, i dashuri imam Rejhan Neziri, të të falënderohem ty dhe xhematit tënd për ftesën vëllazërore që ma bëtë mua dhe sidomos për organizimin e një takimi kaq të rëndësishëm e para së gjithash të domosdoshëm ndërmjet muslimanëve dhe jomuslimanëve, edhe atë në një muaj të rëndësishëm, siç është ky i Ramazanit!

Ramazani është për ne një muaj i veçantë jo vetëm për shkak të agjërimit, por edhe për shkak të faktit, siç besojmë ne muslimanët, është muaji i mëshirës së All-llahut xh.sh., muaj i provimit të durimit dhe i heqjes dorë nga kënaqësitë e kësaj bote për kohë të caktuar. Në këtë muaj kanë filluar të shpallen edhe Fjalët e Zotit, shkrimet e shenjta, në të vërtetë jo vetëm Kur'ani, por edhe Tevrati (Tora) i Musait a.s. dhe Inxhili (Ungjilli) i Isait a.s.

Së fundi do të dëshiroja që ky takim i sontëm të fitojë një kontinuitet në mënyrë që dialogu ndërreligjioz dhe njohja e afërt, e ndërsjellë për të sendërtuar një vlerësim sa më objektiv ndaj **“të tjerëve”** të vazhdojë edhe më tej.

Zonja dhe zotërinj!

Kërkesa për mirëkuptim ndërmjet njerëzve me fe, ngjyra, prejardhje dhe kultura të ndryshme është në të vërtetë një detyrë e thjeshtë. Ajo i nxit të gjithë të interesuarit dhe njëkohësisht kërkon respektimin e shumë aspekteve të ndryshme që i përkasin si vendit të migrimit ashtu edhe vetë migrantëve.

Me anë të **integritit**, në fakt zgjidhen shumë probleme.

Si proces i vazhdueshëm dhe në rritje, i cili fillon që në përditshmërinë tonë, **integrimi** siç mund të jetë një **rrugë** ashtu mund të jetë edhe një **qëllim**, me parakushtin që gatishmëria për këtë proces të ekzistojë në kokat dhe zemrat e të gjithë neve, t'i përfshijë fëmijët dhe të rriturit dhe të mund të ndikojë në mënyrë pozitive në përditshmërinë tonë.

* Mjek dhe Kryetar i Lidhjes së Bashkësive Islame të Zvicrës Lindore e të Principatës së Lihtenshtajnit.

** Kjo është një kumtesë që autori e ka mbajtur më 30 tetor 2004 në tribunën me titull *Integrimi i muslimanëve në shoqërinë zvicerane* të organizuar nga Bashkësia Islame Shqiptare „Hëna e re“ në Kreuzlingen, Zvicër.

Zvicra, nga e cila kanë dalur pionierët e humanizmit si Hanri Dunant dhe të tjerë, që moti nuk është më një ishull i izoluar, porse është bërë një **vend migrimi par excellence** në të cilën imigrantët kanë një origjinë jashtëtakonisht internacionale.

Ndër imigrantët mund të takosh muslimanë të etnive të ndryshme dhe nga vende të ndryshme të prejardhjes. Ata jetojnë këtu si gjenerata e parë, e dytë po bile edhe e treta. Edhe pse nuk u takojnë migrantëve, këtu nuk duhen harruar as edhe zviceranët të cilët në Islam e kanë gjetur qetësinë e prehjen shpirtërore si dhe shprehitë e tyre jetësore. **Ky fakt**, zonja e zotërinj, duhet që gjithnjë të na rikujtojë se është **gabim** që njerëzit t'i përgjithësojmë ose thjesht të gjykojmë në bazë të anës së jashtme të tyre.

Përditshmëria e muslimanëve në një vend me besim tjetër, si në Zvicër, shprehet përmes dy fakteve:

1. **Të qenët ndryshe** – shikuar nga prejardhja, ngjyra e lekurës dhe feja;
2. Nga **sfidat e përditshme** për përshtatje ndaj një mesazhi me njerëz të kulturës, fesë dhe mënyrës tjetër të jetesës, qoftë në jetën private, shkollore ose profesionale.

Ndërmjet këtyre dy fakteve shumë muslimanëve u ka shkuar për dore që të kenë sukses e të kultivojnë **një fushë të frytshme** për nocionet si: mirëkuptim, pranim dhe respekt i ndërsjellë. Nga ana tjetër, disa të tjerë ishin më pak ose aspak në gjendje ta bënin këtë.

Të parët janë të integruarit, kurse **të dytët** janë ata që duhet të bëhen të këtillë. **Për të dytë** është një e përbashkët se ata janë pjesë e shoqërisë, d.m.th. pjesë e shoqërisë sonë.

Nëse nisemi nga fakti se ana e fortë e një shoqërie matet me anëtarin e saj më të dobët edhe nëse ai është një imigrant, na mbetet të mendojmë thellë-thellë se si këta njerëz të arrijnë te një integrim më i mirë dhe më i shpejtë.

Sa për shtytje për këtë nga ana jonë si muslimanë, duhet të theksohet me sa vijon:

1. Dëgjimi i durueshëm

Nëse dikujt ky nder nuk i është dhënë qysh në djep, ai mund ta mësojë më vonë ose thjesht të mundohet ta arrijë atë. Me këtë rast do të tregonte se sa i durueshëm, sa tolerant, sa i interesuar e para së gjithash sa i gatshëm është ai për të dhënë një kontribut me të cilin **njeriu** si i tillë e ndjen veten të kapshëm e të pranueshëm për të tjerët. Një ndjenjë e këtillë, zonja e zotërinj, krijon besimin dhe mënjanon skepticizmin dhe ndjenjën e frikës.

2. Vetëprezantimi

Vetëprezantimi është një mjet qendror në procesin e integrimit. Si mërgimtarët ashtu edhe përgjegjësit vendorë duhet që vetë ta prezantojnë kulturën, fenë dhe shpresat etj. të tyre. Nuk i takon muslimanit të flasë për Hebraizmin dhe Krishterizmin nëse këtu janë prezentë hebrenjtë ose të krishterët, gjithashtu edhe jomuslimanët janë më pak të përshtatshëm të flasin për Islamin nëse muslimanët e dëshmuar mund ta bëjnë këtë.

Përmes prezantimit profesional dhe meritore krijohet një **transparencë** dhe në këtë mënyrë tejkalohen shumë shpejt dhe me efikasitet pengesat dhe keqkuptimet e ndërsjella të çdo lloji.

Vetëprezantimi ndikon që fotografia e vetvetes të mos ndërmjetësohet vetëm në mënyrë të pastër racionale, por lejon që të vijë në shprehje edhe emocionet. Racionaliteti i izoluar në prezantim është po ashtu po aq jo i kompletuar si edhe prezantimi vetëm emocional. Vetëm përzjerja e këtyre të dyjave prezantimin e bën human, të vërtetë dhe të kompletuar.

3. Vënia në shërbim e instrumenteve të domosdoshme

Këtu në rend të parë bën pjesë mësimi i gjuhës së vendit të migrimit, sepse për mërgimtarët:

- **Gjuha** është simbol i dëshirës për komunikim dhe integrim,
- **Gjuha** është çelës për disa dyer të mbyllura në jetë,
- **Gjuha** është përkthyesi i shpirtit dhe mendjes.

4. Krijimi i atmosferës njerëzore, ku nuk dominon frika ndaj njëri-tjetrit, por besimi i ndërsjellë.

5. Respektimi i kërkesave thelbësore të atyre që kanë besime të ndryshme, si p. sh. njohja e muslimanëve si pakicë e cila është e gatshme ta bashkëndërtojë këtë shoqëri dhe të marrë pjesë në detyrat ku kërkohet dhe është e mirëseardhur ndihma dhe kontributi i tyre.

6. Integrimi i të vdekurve, duke i respektuar rregullat islame në çështjen e varrimit. Këtu muslimanët nuk e kërkojnë të pamundurën, por një barazi minimale me pakicat e tjera, si p.sh. bashkësitë çifute në Zvicër.

7. Ndihma dhe lehtësimi në kërkimin e hapësirave të përshtatshme për lutje (namaz) në mënyrë që të mos mbeten të kufizuar në prapakthinat dhe bodrumet e disa komunave ose qyteteve.

Këto ishin vetëm disa mendime dhe rrathë tematikë, të cilëve me dëshirë të mirë përkatëse shumë lehtë mund t'u qasemi. Me këtë vijmë deri te paqja fetare në vend, që është po aq e rëndësishme sa edhe paqja shoqërore.

Nga kjo Ju, zonja dhe zotërinj, shihni se integrimi nuk është rrugë njëkahëshe. Ky është një proces i dyanshëm që në të njëjtën masë i nxit si njerëzit e këtushëm ashtu edhe mërgimtarët.

Muslimanët, siç besoj unë, janë të vetëdijshëm për detyrat e tyre dhe shumë prej tyre janë përgjegjës në Lidhjet e Bashkësive islame ose dhe nëpër shoqata të veçanta dhe punojnë me përpikëri e zell që të tregojnë se **integrimi** është një akt i rritjes së përbashkët dhe i ndërlidhjes, e jo akt asimilimi, i cili kërkon adaptim (përshtatje) të plotë në çdo gjë.

Qëndrimi i Islamit lidhur me integrimin është i qartë dhe pa asnjë keqkuptim... Ai e nxit **integrimin** dhe ua ofron ithtarëve të vet si obligim, sepse ai në të sheh **bazën** për afrimin e njerëzve, kurse zbatimin e tij e sheh si **rezultat** të frytshëm të bashkëpunimit në mes të gjithë pjesëtarëve, qofshin ata individë, instanca apo organe të pushtetit.

Në Kur'an, në suren el-Huxhurat, 49, ajeti 12, mund të lexohet:

“O ju njerëz, Ne vërtet ju kemi krijuar prej një mashkulli e një femre dhe ju kemi bërë popuj e fise që të njiheni në mes vete. Vërtet më i ndershmi prej mesit tuaj tek All-llahu është më i devotshmi prej jush. Vërtet All-llahu është i ditur dhe i informuar mirë”.

Ne muslimanët që jetojmë në këtë mes të Zvicrës lindore i shohim dhe i vlerësojmë të gjitha tentimet për zbatimin praktik të qëllimeve të parashtruara për integrim. Gatishmëria për dialog e shfaqur nga pushteti dhe instancat jomuslimane te ne has në zemra e veshë të hapur. Për këtë arsye ne kemi vendosur që të mos qëndrojmë pasivë ndaj këtyre proceseve andaj edhe më 1 mars 2003 kemi themeluar **DIGO**-n (Dachverband islamischer Gemeinden der Ostschweiz und des Fürstentums Liechtenstein – Lidhja e Bashkësive Islame të Zvicrës Lindore e të Principatës së Lihtenshtajnit).

Ndër qëllimet kryesore të deklaruara të DIGO-s, ndër të tjera bëjnë pjesë:

1. Përfaqësimi i interesave të bashkësive islame në institucionet jomuslimane dhe në qeveri,
2. Nxitja e njohurive islame te vetë muslimanët, te fëmijët e tyre dhe te fëmijët e fëmijëve në mënyrë që të mos humbet identiteti dhe besimi i tyre,
3. Të paraqitemi me tolerancë, dialog, respektim të nderit të njerëzve duke i respektuar normat politike, shtetërore bashkërisht për krijimin e një baze stabile për bashkëpunim, integrim dhe respektim të të drejtave të njeriut,
4. Të jemi një partner i besueshëm bisedimi dhe kooperativë për të gjithë.

Nga ata që qëndrojnë përballë nesh (shteti dhe institucionet joislame) presim të na pranojnë e njohin si partnerë të vullnetit të mirë si dhe të tregojnë një respektim më të madh të të drejtave që na takojnë si pakicë dhe qytetarë të këtij vendi, në mënyrë që paqa e theksuar aq shumë t'i mbushë zemrat tona dhe toleranca pozitive e konstruktive ta përcaktojë përditshmërinë tonë në raportet e ndërsjella në mes njerëzve.

Le të shpresojmë që takimi i sotëm me të gjithë Ju, muslimanë e jomuslimanë, të bëhet një simbol i përhershëm i paqes së qëndrueshme në mes nesh si njerëz të cilët përfaqësojmë kultura e fe të ndryshme, por që në fakt kanë një origjinë të njëjtë, në bazë të çkaje kemi edhe shumë sende të përbashkëta.

Poeti zviceran Johann Caspar Lavater ka thënë:

*“Na lejo të jemi një dritë mbi tokë,
Dhe një shembull i besnikërisë së përhershme,
Të lirë si jemi ne të bëhen edhe të tjerët!
Lejo që të gjithë të jetojnë të sigurtë,
Derisa koha t'i mbyllë dyert,
Derisa nga të gjitha kombet vetëm një të bëhet”.*

Në këtë kontekst Kur'ani në suren e tretë Alu Imran, ajeti 64, thotë:

“Thuaju (o i Dërguar): ‘O ithtarë të librit (Tevratit e Inxhilit), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe jush – Të mos adhurojmë pos All-llahut askë dhe të mos i bëjmë atij shok; të mos konsiderojmë njëri-tjetrin për zotër pos All-llahut!’ E në qoftë se ata refuzojnë, ju thuajuni: ‘Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam në një Zot)!’”.

Zonja dhe zotërinj!

Me këtë thirrje le të sundojë mbi sipërfaqen e tokës paqa fetare dhe të gjithë njerëzit le ta gjejnë në të fatin e tyre, pa pikë frike, racizmi e terrori!

Gjeneratave që vijnë ne ua kemi borxh këtë, duke e kuptuar me seriozitet përgjegjësinë tonë të tashme.

Zonja dhe zotërinj, unë Ju falënderoj për vëmendjen dhe interesimin që treguat!

Ves-salam!

Nga gjermanishtja:
Xhelal Qazimi